



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE

Nr. 1656/prot.

Tiranë më 12. 11. 2019

Lënda: Mendim mbi projektligjin "Për shërbimet e pagesave".

MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË

Tiranë

Në përgjigje të shkresës tuaj nr.18631 Prot., datë 17.10.2019, me anë së cilës kërkohet mendim mbi projektligjin "Për shërbimet e pagesave", në tërësi projekti vlerësohet i hartuar konform ligjit nr.9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.

Ndërkohë, duke qenë se projektligji në dispozita të caktuara të tij, parashikon përpunimin e të dhënave personale, duhet të reflektohen ndërhyrjet si më poshtë:

Pas germës hh), të pikës 1, të nenit 5, të shtohet përkufizimi: "*Pëlqim i subjektit të të dhënave*", ka të njëjtin kuptim me atë të parashikuar në ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale".

Pas germës ww), të pikës 1, të nenit 5, të shtohet përkufizimi: "*Transferim ndërkombëtar*" është dhënia e të dhënave personale marrësve në shtetet e huaja.

Pas pikës 1, të nenit 22, të shtohet një pikë me këtë përmbajtje: "*Institucionet e pagesave marrin të gjitha masat e nevojshme të sigurisë, në zbatim të parimeve ligjore mbi transferimin ndërkombëtar të të dhënave me qëllim garantimin e nivelit të mbrojtjes së të dhënave personale nga palët nënshkruese*".

Në nenin 23, sugjerojmë riformulimin e afatit të ruajtjes së të dhënave. Afati i parashikuar në këtë dispozitë, "*të paktën 5 vjet*", lë vend për interpretim duke rezultuar si afat i pa limituar në kohë. Për rrjedhojë, sugjerojmë parashikimin e një afati të ruajtjes së të dhënave të mirë përcaktuar.

Gjithashtu, në këtë nen, në përputhje me parimet e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, sugjerojmë të shtohet edhe një paragraf me këtë përmbajtje: "*Të dhënat personale të mbledhura për qëllime të këtij ligji, anonimizohen ose asgjësohen pas*

përbushjes së qëllimit të grumbullimit, sipas afatit të përcaktuar në këtë nen dhe parimeve të parashikuara në legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.”

Në pikën 3, të nenit 26, në fund të fjalisë të shtohet togfjalëshi “...dhe të garantohet niveli i mbrojtjes së të dhënave personale.”

Në fund të pikës 2, të nenit 87, sugjerojmë të shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:
“Ofruesit e shërbimeve të pagesave duhet të informojnë subjektin e të dhënave për të gjithë procesin e përpunimit të të dhënave personale, në zbatim të detyrimeve ligjore.”

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

